



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 545, Datë 20.09.2018**

**“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në Sektorin Bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e sektorit bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraparak në sektorin bankar,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e e sektorit bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraparak në sektorin bankar për periudhën kohore nga 01 Janari 2016 deri në 31 Maj 2018. Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes se këtij vendimi.

2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë bankave objekt hetimi dhe është kërkuar informacion prej tyre në mënyrë shkresore.
3. Koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 516, datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në sektorin bankar, për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”, të ndryshohet si vijon:

*“3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 22 nëntor 2018.”*

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**